



TEG
Be happy!



RECYCLING CREATIVE

ARCHITECTURE YOU CAN SIT ON!



RREGULLORE

KONKURSI KOMBËTAR I ARKITEKTURËS: RIKIKLO – KREATIV '22

Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës (FAU) në Universitetin Politeknik të Tiranës, në bashkëpunim me Research Center for Improving Built Environment, programin B4Students, si dhe me mbështetjen e Tirana East Gate (TEG), organizojnë konkursin kombëtar të arkitekturës me studentët **"Riciklo – Kreativ '22"** me temën e riciklimit të mbetjeve urbane dhe mjedisore.

Konkursi synon të përfshijë studentë të të gjitha profileve të degës së Arkitekturës, pjesë e të gjitha IAL-ve në Shqipëri. Studentët janë të ftuar të projektojnë në këtë konkurs **një ulëse** për ambiente publike urbane apo dhe të interierit, të përbërë ekskluzivisht nga një material i ripërdorshëm.

Konkursi krijues do të shpallë fitues të çmimeve për 3 vendet e para.

Regjistrimi nga studentët kryhet në bit.ly/riciklo-kreativ-22.

Afati i fundit për regjistrim është data **10 maj 2022**.



KONKURS I ARKITEKTURËS SË MATERIALEVE TË RICIKLUESHME

Konkursi Kombëtar i Arkitekturës "Riciklo – Kreativ '22" propozohet nga Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës në Universitetin Politeknik të Tiranës dhe programi B4Students dhe ka disa qëllime:

1. Të vendosë studentët në kontakt me konceptin e "materialeve për tu hedhur" dhe në të njëjtën kohë, të ndërgjegjësojë qytetarët për raportin ndaj prodhimit të tepërt të këtyre mbetjeve urbane.
2. Ti krijojë mundësinë studentëve për aftësim praktik nëpërmjet krijimit të një vepre kreative - një ulëse, qoftë në formën e një stoli apo elementi ku mund të ulësh, në shërbim të qytetarëve, të përbërë tërësisht nga materiale të riciklueshme, të transformuara nëpërmjet një koncepti të qëndrueshëm, me përmasa 2m x 1.5m x 1.5m.
3. Ti krijojë mundësinë studentëve të promovohen profesionalisht me maketet (prototype) në një ekspozitë kreative në mjediset e Tirana East Gate (TEG), nëpërmjet së cilës do të rritet ndërgjegjësimi mbi ripërdorimin masiv të materialeve si plastika, goma, xhami, druri, metalet, etj., në ambientin tonë të jetesës.

PJESËMARRËSIT NË KONKURS

Konkursi Kombëtar i Arkitekturës "Riciklo – Kreativ '22" është një aktivitet krijues, i hapur për të gjithë studentët në Shqipëri, të regjistruar si individ apo në grupe me deri në 3 anëtarë. Grupi mund të jetë i përbërë nga studentë të të njëjtit Fakultet apo Fakultete të ndryshme të vendit.

Pjesëmarrësit janë të lirë ta mendojnë pozicionimin e veprës në çdo lloj ambjenti publik. Megjithatë, do të jetë e nevojshme të zgjidhen vendndodhje "me ndikim të lartë", në mënyrë që mesazhi të përçohet në audiencën më të gjerë të mundshme.

Ekspozita me maketet (prototype) e modeleve të propozuara do të qëndrojë e hapur në TEG për 10 ditë. Maketet duhet të përgatiten në shkallë 1:1, me përmasa jo më të mëdha se: 2m x 1.5m x 1.5m dhe të realizuara me materialin e riciklueshëm që propozohet. Së bashku me maketin (prototype) do të ekspozohen edhe posterat shoqërues përkatës (në format A1).

ÇMIMET E KONKURSIT

Konkursi Kombëtar i Arkitekturës "Riciklo – Kreativ '22" do të shpallë 1 çmim të parë, 2 çmime të dyta dhe 2 çmime të treta. Çmimet në para do t'u jepen fituesve në mënyrat e mëposhtme:

- 1000 € për vendin e parë;
- 2 x 600 € për vendin e dytë;
- 2 x 400 € për vendin e tretë.

Të gjithë studentët të cilët do të ekspozojnë maketet (prototype) do të pajisen me certifikatë vlerësimi për pjesëmarrje në konkurs. Për fituesit do të jepen certifikatat përkatëse, sipas vendeve.

Përzgjedhja dhe shpallja e fitueseve do të bëhet në ceremoninë e ndarjes së çmimeve, që do të organizohet në ditën e fundit të ekspozitës në mjediset e Tirana East Gate (TEG).

Projektet më të mira do të promovohen nga FAU, BEREC, B4Students dhe TEG.



PARAQITJA E PROJEKTIT

Propozimi krijues duhet të paraqitet me maket (prototype) në shkallë 1:1, me përmasa jo më të mëdha se: 2m x 1.5m x 1.5m, të realizuar me materialin e riciklueshëm që propozohet, si dhe në një fletë të vetme A1, e cila do të emërtohet me një kod identifikimi të ekipit projektues.

Pra, fleta A1 dhe maketi janë anonime, nuk pranohen elemente identifikuese përveç projektit.

Kodi i identifikimit të projektit do të jetë një numër 5 shifror, i cili do të propozohet nga vetë aplikanti/projektuesi apo grupi i projektimit, në momentin e regjistrimit në konkurs. Dorëzimi i koncept-idesë të projektit (fleta A1) dorëzohet në Fakultetin e Arkitekturës dhe Urbanistikës (FAU) brenda afatit të shpallur. Dorëzimi i projektit përtej këtij afati nuk është i lejuar.

Projekti duhet të jetë i shkruar në SHQIP dhe jo më shumë se 250 fjalë brenda posterit A1. Mënyra e kompozimit të posterit është e lirë. Propozimi mund të bëhet me teknikën e zgjedhur nga kandidatët (diagramë, skica, modele dhe vizualizime 3D, vizatime CAD, etj.).

Aplikantët do të informohen me email për detaje të mëtejshme lidhur me ekspozitën në TEG.

SI TË MARRËSH PJESË

Aplikimi për pjesëmarrje në konkurs duhet të kryhet online në linkun bit.ly/riciklo-kreativ-22.

Maketi i realizuar (prototype) dorëzohet nga studenti në TEG në dt. 18 qershor 2022.

Specifikimet e mëtejshme mbi ekspozitën do të jepen në një kohë të dytë.

Pjesëmarrja në konkurs është pa pagesë.

DATA TË RËNDËSISHME

- | | |
|---------------------------------------|----------------------------------|
| ▪ Regjistrimi online: | brenda dt. 10 maj 2022 |
| ▪ Afati i dorëzimit (fleta A1): | brenda dt. 31 maj 2022 |
| ▪ Përzgjedhja/shpallja e finalistëve: | brenda dt. 7 qershor 2022 |
| ▪ Dorëzimi i maketit (prototipit): | 18 qershor 2022, TEG |
| ▪ Periudha e ekspozitës: | 19-26 qershor 2022, TEG |
| ▪ Shpallja e fituesve: | 26 qershor 2022, TEG |

VLERËSIMI

Vlerësimi i fituesve do të ketë 2 komponentë:

- 70 % e vlerësimit do të jetë nga Juria e ngritur (brenda datës 26 qershor 2022).
- 30 % e vlerësimit do të jetë nga publiku, i cili do të votojë në mjediset e ekspozitës në TEG.